

KOSOVARJA

Ballina: Ledi Vokshi Marcelino

Si jetojnë
banorët
e Bajgorës

Pse
çdo ditë
po ndodh
nga një
dhunim
në Kosovë

Ç'thonë gratë
e biznesmenëve

Mu kënaq
zemra që
gruas sime
ia ndalën
rrogën

Takime
të shumta
të UB-së

LEDI
VOKSHIN
*sfidat e bënë
të pandalshme*

remos

DENTFIX

HELPER
GENÈVE

SHERWOOD
Beauty and Health

allüre
cosmetics

UB
UNION BUSINESS
ALBANISCH & DEUTSCH

DINO
CERAMICHE

Shkabaj
FISH FARM

MOLLA

Shkencën Dëshmor
Chetëzë shkollore

Banaderm

MARITIM
MARITIM HOTEL & SPA

CIMA
CIMA HOTEL & SPA



DINO
QERAMIKA

DINO QERAMIKA

Një gamë e strukturuar ngjyrash, efektesh dhe përfundimesh, të aftë për të kënaqur shijet dhe nevojat më të ndryshme estetike përmes kombinimeve të koordinuara ose kontrasteve të përzierjes dhe përputhjes.



Na Vizitoni

Magjistranja Prishtinë
Ferizaj - Konjuh



dino-company.com



+383 49 566 667

A close-up portrait of Ledi Vokshi, a woman with long, dark, wavy hair, wearing a black V-neck top and large diamond earrings. She is looking directly at the camera with a slight smile.

Në ballinë: Ledi Vokshi

Sfidat që e bënë të pandalshme

Sapo e dëgjon emrin e Ledi Vokshit, menjëherë të vijnë në mendje shumë gjëra. E njohur si një nga vajzat e para që ka kënduar hip-hop në Shqipëri, për hitin e saj “Çuna si ti Durrësi ka plot”, pastaj për pjesëmarrjen e saj në “Shpija e Kosovës” dhe, gjithashtu, për bamirësi.



Por, jo vetëm kaq. Ledi Vokshi është edhe femra që i ka përdorur mediet sociale në avantazhin e saj për të filluar dhe zhvilluar biznese. Për shumë vite Ledi Vokshi ka qenë prezent në të gjitha mediet, por edhe në shumë udhëtime nga Nju-Jorku në Shqipëri e Kosovë, duke investuar në industrinë e muzikës dhe jo vetëm.

Pse u zhduk Ledi?

Në pesë vitet e fundit Ledi ka qenë duke marrë trajnime intensive për zhvillim personal dhe të biznesit, në shitje dhe në marketing të medieve sociale.

Gjatë katër viteve të fundit, Ledi Vokshi jo vetëm që u martua, por i ka lindur edhe dy fëmijë, e gjithashtu ka ngritur edhe dy platforma biznesi, një në industrinë e trajnimeve "PowerUP Woman", që ofron trajnime dhe kurse, e një kompani në industrinë e teknologjisë, duke ofruar shërbimet IT, të cilën ajo dhe bashkëshorti i saj, Luis Marcelio, e kanë ndërtuar dhe zhvilluar në një kohë shumë të shkurtër.

"Kur mora vesh që isha shtatzënë, ishte koha për të mos arsyetuar më, por për të ndërtuar një familje me traditë të reja", tha Ledi.

Gjithsesi, ani pse me status tjetër, ajo dhe bashkëshorti i saj e filluan kompaninë e IT-së. Ledi u desh të rikthehej në shkollë pas 17 vitesh, ndërkohë që ishte shtatzënë dhe me shumë borxhe për ngritjen e kompanisë me rëndësi për të dhe të shoqin.

Ledi u fiksua pas gjetes së zgjidhjeve të problemeve në përgjithësi, madje jo vetëm duke mësuar, por këtë herë edhe duke e vënë në funksion atë çfarë ajo po mësonte në këtë rrugëtim.

Qëllimi i saj ishte të gjente mënyra të reja zgjidhjesh në ato që ajo kishte dështuar më parë, të cilat donte t'i ndante me të tjerët, gjë që e bën suksesshëm sot.

Ledi arriti ta merrte kontrollin mbi jetën e saj, të shpërfaqte kapacitete të jashtëzakonshme si një femër me eksperiencë dhe si sipërmarrëse në industri të ndryshme, si në argëtim, shitje, ndërtim, burime njerëzore dhe teknologji.

Më parë, kur kishte dështuar diku, thjesht, kishte hequr dorë, por jo më. Jeta e saj ndryshoi në kohën e pandemisë, meqë kompania e IT-së, që e kishin themeluar me bashkëshortin, po rritej shumë shpejt. Shumë të tjerë po vuanin, veçanërisht në aspektin e biznesit, por jo edhe Ledi, meqë biznesi i rritej.

Kjo femër e fuqishme tashmë e ka marrë jetën në duart e saj, e kjo edhe duke i parë prindërit që u përpoqën shumë në jetë, që shkuan në Amerikë për një jetë të re në moshën 50-vjeçare, për ta fituar kontrollin mbi jetën e tyre, pastaj për dy djemtë e saj, ngase e kishte kuptuar se për të qenë bashkëshorte e nënë e mirë, fillimisht, duhet ta rriste veten fuqishëm.

Kështu, këngëtarja sensacionale e dikurshme filloi t'i ndihmonte gratë me trajnime virtuale

që t'i mësonte se si t'i kthenin pasionet e tyre në fitime monetare.

Ledi po i mësonte ato si të përdornin historinë e tyre dhe mediet sociale për ta kthyer pasionin në të ardhura konkrete financiare.

"Mund ta përballojmë çdo sfidë kur pesë gjëra hyjnë në lojë: historia, qëllimi, aftësitë, veprimet dhe përgjegjësia", thotë Ledi.

Në "Kosovare" ajo tregon hapur për veten, jetën dhe arritjet e saj mbresëlënëse...

Kush është Ledi sot?

- Një grua që pas shumë vitesh, duke i rënë "murit me kokë", vendosi të punonte me mendësinë dhe filloi të jetonte dhe punonte drejt realizimit të gruas që ajo donte të bëhej, jo nga mënyra se si dukej apo i bënte gjërat, por nga mënyra se si ajo ndihej.

Çfarë të shtyu të bëheshe kjo që je sot?

- Unë kam kaluar shumë në jetë. Çdo herë që lëndohesha, ngrihesha sërish dhe filloja nga fillimi. Gjithmonë bëja paqe me gjërat që më ndodhnin mua, por nuk analizoja pse më ndodhnin dhe si mund t'i parandaloja në vazhdimësi.

Forcën për të ecur përpara e kam marrë nga prindërit e mi. Ata janë arsyeja që unë kam forcë dhe kurajë për të mos hequr dorë kurrë. Ata kanë filluar nga zero disa herë. Nëse atyre nuk u pëlqente diçka, ata do të luftonin për ta ndryshuar atë. Ata asnjëherë nuk ishin të qartë për destinacionin e jetës së tyre, por e dinin që donin një jetë më të mirë.

Por, ishte koha ndryshe...

E unë, këtë herë u detyrova të filloja të analizoja pse këto dështime, dëshpërime dhe sfida?

Cilat kanë qenë sfidat e jetës për ty?

- Kur erdhi pandemia, unë po përballesha me sfidën më të madhe, pasi të dy prindërit e mi ishin të sëmurë në spital, i kisha dy fëmijë të vegjël, isha duke ndërtuar një biznes, duke mësuar si të isha një grua për bashkëshortin tim dhe mendoja që nuk isha duke bërë mjaftueshëm. Doja të bëja më shumë, të kisha më shumë... Dhe, duke u munduar të gjeja balancën, i bëja dhe i arrija të gjitha, madje dhe duke i bërë të lumtur të gjithë.

Çfarë hapash ndoqe?

- E kuptova se kisha ngecur midis dy botëve: Jeta ime e mëparshme me traditat dhe ato të reja që unë po i ndërtoja.

Isha zinxhiri që po i mbante të gjithë të lumtur, prandaj unë duhej të isha e fortë mjaftueshëm që mos të thyhesha.

Njerëzit thonë se jeta është balancë. Kjo është gënjeshtër. Jeta është gjithçka rreth marrjes së vendimeve të shpejta dhe kur merr vendime disa do të humbin dhe disa do të fitojnë.

Unë nuk mundesha më të bëja çdo gjë dhe nuk mund të fitoja gjithmonë...

Pse e vuajta kaq shumë traditën, të kaluarën tënde?

- Fillova të gjykoheja shumë nga njerëzit. U martova me një person që nuk ishte shqiptar. Burri im është i lindur në Republikën Dominikane dhe i rritur në Holandë.

Njerëzit nuk e pranonin se si një vajzë, e që bën kaq shumë për komunitetin shqiptar, mund të bëjë diçka të tillë.

Pastaj, u gjykova sepse mendonin se unë mund ta kisha shfrytëzuar atë për lekë, ndërkohë që unë dhe ai ishim në borxhe deri në fyt, duke e ndërtuar kompaninë tonë.

Kur i lindi fëmijët, fillova të gjykoheja për mënyrën se si t'i rrisë, si t'u flasë etj.

Presioni vazhdonte non-stop rreth asaj se si ta jetoja jetën, si t'i rrisja fëmijët, si ta mbaja traditën dhe kulturën tonë gjallë.

Kam kaluar shumë sfida në jetë, si bullizmin, abuzimet nga më të ndryshmet, verbale, fizike, seksuale, por asgjë nuk ishin ato kur e sfidon mendësinë dhe traditën tënde, e kur i ke edhe dy fëmijë për t'i rritur.

Çfarë vendimi more për ndryshim?

- Fillova një luftë që do ta fitoja, se nuk mund të kthehesha më mbrapsht te ajo Ledi që mendonte ta bënte çdo njeri të lumtur dhe të ishte mirë me të gjithë.

Lufta ime ishte me mendësinë time dhe me traditën. Unë mundohesha të jetoja në një botë të vjetër, e cila nuk kishte evoluar ashtu siç mendoja unë dhe, po ashtu, jetoja një botë të re, në të cilën gjërat ndryshonin shumë shpejt.

Dhe, duke i analizuar dështimet dhe gjërat që po i vuaja, erdha te pika e vendimit: Vendosa që sa herë ta vëreja veten që po analizoja dhe po merresha me mendime negative, shembull, me fjalët e njerëzve, urgjentisht t'i rregulloja dhe të mos zgjohesha në mëngjes e mërzitur.

Aq e vështirë ishte ta mbaja traditën shqiptare gjallë, a?

- Unë e adhuroj traditën time, e burri im e respekton shumë. Por, janë disa gjëra që janë futur në funksion nga më të vjetrit, të cilat nuk funksionojnë në botën e re.

A jam më pak shqiptare nëse nuk i mbaj traditat gjallë?

A jam më pak shqiptare nëse nuk i kuptoj të gjitha fjalët shqip?

A jam më pak shqiptare nëse fëmijët e mi nuk janë 100 për qind shqiptarë?



Unë jam shqiptare, por isha e lodhur dhe po vuaja nga fjalët që i dëgjoja, si: "Kështu duhet bërë", "Kështu e kemi ne", "Kështu bëjnë shqiptarët", "Mëso të flasësh shqip"...

A jam nënë e keqe nëse dua të bëj më shumë për veten, nëse dua të punoj, nëse dua ta kem parane time?

A jam më pak grua nëse dua të jem edhe grua për burrin tim, edhe nënë për fëmijët e mi, e edhe ta kem një profesion që më bën të lumtur?

Si e ke vënë në funksion vendimin që more?

- Ndërtova një hartë për veten time. Ishin pesë pikat që duhej t'i ndiqja. Pavarësisht sa hapa kthehesha prapa, duhet të rifilloja sërish dhe në ditën që do t'i masterizoja këto pika, atëherë do t'i hapja dyert për t'ua mësuat të tjerëve.

Cilat janë ato pika që i vure në funksion?

- Historia që i thosha vetes:

Çfarë është arsyeja e kësaj?

Çka më duhet të mësoj nga kjo?

Çfarë është plani që kam vendosur?

Nëse nuk e arrij vetë, kush duhet t'më ndihmoj ta arrij këtë?

Çfarë do t'i thoshe vetes, Ledit të viteve më parë?

- Çohu çdo ditë dhe thuaj vetes: "Unë nuk duhet të di çdo gjë vetë! Kujt mund t'i kërkoj ndihmë që të më ndihmoj të arrij më shpejt në destinacionin që dua?".

Çfarë të ndihmoi?

- Qartësia. Sepse, një nga trajnimet e para ku investoja ishte ai ku mësoja se si të isha e qartë me veten. Nëse nuk do të isha e qartë se ku doja

të arrija, do të ishte e pamundur.

Prandaj, në trajnimin tim hapat e parë janë gjithmonë "Mendësia & Qartësia", sepse pa këto dy gjëra do të dështojmë gjithmonë gjatë rrugës.

Çfarë do të thotë sukses për ty?

- Duke u zgjuar çdo mëngjes me buzëqeshje në fytyrën time dhe pa stres.

Si është ta menaxhosh jetën familjare, private dhe profesionale?

- Luisi dhe unë jemi të dy në të njëjtin rrugëtim. Ne, të dy, kemi vlera të njëjta familjare dhe ndonjëherë duhet të bëjmë sakrificë, në mënyrë që të arrijmë aty ku duam. Net të vona duke punuar, zgjim herët në mëngjes.

Është gjëja më e rëndësishme për ne, të dy, të shijojmë fëmijët, ndërsa janë akoma të vegjël. Por, ndonjëherë duhet të punojmë kur pjesa tjetër e botës është akoma duke fjetur, që ne të mund të bëjmë sa më shumë në 24 orëshin e ditës. Koha me familje dhe koha private me njëri-tjetrin nuk është e diskutueshme, kjo është arsyeja pse ne ndërtojmë biznes që punojnë për ne, në vend që ne të punojmë për biznesin.

Çfarë të bën të pandalshme?

- Kur e kupton që ke lindur për të vdekur, se çdo ditë, deri në fund, do të bësh çdo gjë me fuqinë tënde për të jetuar një jetë me shumë qëllime, njëkohësisht duke u ndihmuar edhe të tjerëve. Vetëm kështu njeriu ka një arsye që zgjohet çdo ditë e të mos ndalojë në rrugën e përm-bushjes së misionit personal.

Si i ndihmon të tjerët me trajnimet e tua?

- I ndihmoj të tjerët të kenë liri dhe kontroll mbi jetën e tyre. Lirinë e fiton pasi të kesh punuar shumë me mendësinë tënde dhe je gati të arrih çdo gjë. Kontrollin njeriu e fiton pasi ka filluar të bëjë para. Në kohët e sotshme nuk është aq e lehtë ta përdorësh median sociale, t'i rrisësh dhe t'i shesësh shërbimet tua.

Misioni yt për të ardhmen?

- Adhuroj të gjej zgjidhje të problemeve të ndryshme dhe, pasi t'i kem gjetur, t'u mësoj edhe të tjerëve. Kështu, t'ua bëj jetën më të lehtë. Pra, sa më shumë mësoj, aq më tepër i mësoj dhe ndihmoj të tjerët. Unë do të vazhdoj t'i mësoj të tjerët se si ta fitojnë lirinë dhe kontrollin e jetës së tyre, duke përdorur mendësinë e tyre, median sociale dhe bizneset. Liria fitohet me mendësi, me qartësi, e kontrolli fitohet duke i shfrytëzuar rrjetet sociale për të përfituar të ardhura.

Nderim Neziri



As tatari s'i bie në fije...



A po e di kush *sa po shkon pasuli në Kosovë?*

Disa thonë të vazhdohen grevat. Qohet grupi i Qeverisë dhe thotë duhet të ndalen grevat.

E, Sindikata e arsimit ka deklaruar se greva vazhdon.

Kryeministri me Bulliqin në Podujevë shpërndajnë Abetare...

Ec e bjeri në fije çka po ndodh në këtë vend?!

Përzierjen e bën edhe më të ashpër dhe më bindëse kur ndjen se mësimi po humbet çdo ditë e më shumë dhe ajo pak shkollë që ishte...

Vetëm diçka është e saktë në Kosovë: Inatet!

Për inate bëhen të gjitha. Shpërfillet ligji, anashkalohen sindikatat, prononcohen partitë dhe personeli që punon në kuadër të Qeverisë.

Ka individë, si, bie fjala, Mimoza

Kusari-Lila që thotë: "Nxënësit të kthehen në shkollë".

E, a i takon Mimosës të merret me këtë problem?!

Disa e etiketojnë SBASHK-un me SHIK-un, më UDB-ën e çka jo tjetër!

Dhe, për sherr, hasa në një deklaratë të Kurtit të vitit 2019, ku grevistëve u jep kurajo të mos e ndalin grevën!

Pra, Albini i vitit 2019 thoshte mos e ndalini grevën, e Albini i vitit 2022 thotë ndaleni grevën!

Madje, punëtorëve të arsimit ua ka reduktuar rrogat!

Vlora Çitaku, nënkryetare e PDK-së, ditë më parë deklaroi se "Arkivi është armiku më i madh i Albin Kurtit".

Kjo do të thotë se Albini i tashëm është kundër Albinit të dikurshëm që ishte në opozitë...

Dikur ishte për rritje pagash, kurse tash i redukton ato!

Ishte me grevistët, tash i shantazhon ata!

Ishte me klasën punëtoare, tash është kundër klasës punëtoare!

Ishte me sindikatat, tash është kundër sindikatave!

Ishte kundër bisedimeve me Serbinë, tash bisedon me Serbinë!

Ishte kundër negociatave, tash bën negociata!

Ishte i dashuruar në Diasporën, tash i quan analfabetë!

Keq, a?

Sepse, në gjithë këtë katrahurë, më së shumti po pëson brezi i ri, "brezi i bukur i ardhmërisë".

Safet Krivaça

PASIONI I SHFRENUAR PËR PUSHTET E PRISHË NJERIUN!



Është provuar se pasioni i shfrenuar për pushtet e prishë njeriun. Por, ata që nuk i njohin vlerat njerëzore janë të prishur vetë. Ata vetëm presin rrethanat e favorshme për të hequr mbulesën e çnjerëzimit të tyre.

E, rrethanat në Kosovë janë bërë të favorshme për ta. Andaj, edhe kanë të drejtë ata që thonë se miqtë e Kosovës janë më të interesuar ta forcojnë shtetin tonë se sa vetë ne, shqiptarët.

Ne sikur nuk po e dimë, as që duam ta dimë, as ta kuptojmë, se pushteti është një përgjegjësi dhe jo një vend pune.

*

Çdo mbret i madh ishte një fëmijë që qante dhe çdo ndërtesë e madhe ishte vetëm një plan në letër. Nuk është me rëndësi se në çfarë gjendje je sot, por me rëndësi është që ta avancosh veten dhe të vendosësh se çka do të jesh nesër...

Çka do të jesh nesër për vete, për fëmijët e tu...

*

Një mendim i pëlqyer: Në planetin tonë jetojnë edhe gjallesa helmuese që helmojnë njerëzimin e kombet.

*

Kur isha shtatë vjeç, nëna më thoshte e ma përsëriste gjithmonë: Lumturia është çelësi i jetës! Kur shkova në shkollë, mësuesi më pyeti çka do të dëshiroja të bëhem kur të rritem. Unë nuk iu përgjigja fare. E lash faqen bardhë, pa e shkruar dëshirën time.

Mësuesi, me të parë që unë nuk isha përgjigjur fare, më tha se nuk e kisha kuptuar pyetjen apo pse nuk isha përgjigjur. Unë iu gjegja: "Ende nuk e kam kuptuar jetën!"

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Rilinda Krasniqi

Ardita Dili

Dizajni:

Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

Si iu vranë Mulla Ademit të Keqekollës 25 anëtarë të familjes?

Një shtëpi me drurë të fortë akoma qëndron buzë asfaltit rrugor në Keqekollë. Oborri i saj është mbushur thera e barë. E shkelin vetëm bagëtia që kullosin.

Shtëpia është akoma në këmbë e askush nuk përkujdeset për të... Kjo shtëpi, vitin e kaluar, veç i ka mbushur një shekull qëkur në oborrin e saj çetnikët prenë dhe masakruan 25 anëtarë të familjes së saj. Ishte ditë e tmerrshme që hoxhës nga Keqekolla iu vranë 25 anëtarë të familjes. Tre të tjerë, e që shpëtuan, qëlluan gjëkund. Ishte nusja me dy fëmijë që fati deshi të mos qëllonte në shtëpi atë ditë. Kishin kaluar hordhitë çetnike me ushtri aty pari dhe i pari i tyre ishte futur në shtëpinë e hoxhës. E kishte pyetur të zotën e saj sa

anëtarë familjeje i kishte. Hoxha i ishte përgjigjur se i kishte 28 anëtarë të familjes. Çetniku serb i kishte thënë a jeni të gjithë këtu dhe hoxha i kishte treguar se 25 vetë ishin në shtëpi. Çetnikët i kishin urdhëruar të dilnin nga shtëpia të gjithë dhe të rreshtoheshin në oborrin bregor të shtëpisë. Me t'u rreshtuar në oborrin para shtëpisë, duke filluar prej hoxhës i kishin prerë të gjithë, 25 anëtarë të familjes së tij në Keqekollë. Dhe, shtëpia kishte mbetur e vetmuar, pa njerëz. Ajo edhe tani sikur qanë...

VARRIMI NË BUNARIN E OBORRIT!

Pas vrasjes së të gjithë familjes së hoxhës para shtëpisë, fshati ishte tubuar në shpejtësi të shihnin kufomat e familjes së hoxhës dhe pasi panë tmerrin e nuk kishin mundësi të hapnin 25 varre atë ditë, kufomat i hedhin në bunarin e oborrit. Pastaj, e mbulojnë bunarin me gurë e mbeturina.

Sot bunari nuk dihet se ku është, por një ekip institucional do të mund të qonte punën e hulumtimit të hapjes së bunarit dhe në bashkëpunim me fshatin të zbardhin më shumë detaje për atë ditë të vitit 1921, në të cilën u vranë 25 anëtarë të familjes së hoxhës në Keqekollë. Edhe një mundësi e artë do të ishte që shtëpia të shpallej nën mbrojtje institucionale, sepse ajo akoma dukej e fortë nëse qysh tash bëhet mbrojtja e saj nga shiu dhe bora. Ajo ende i kishte dyert dhe dritaret të forta, ashtu që reagimi i shtetit për ta mbrojtur do të ishte efikas për brezat që vijnë, e që do mësojnë se Serbia ka bërë krime në vazhdimësi dhe jo vetëm në luftën e vitit 1999 në Kosovë. Ajo ka bërë krime të tmerrshme edhe në vitin 1878, kur edhe ka ndodhur dyndja masive e shqiptarëve nga Toplica, e edhe më 1921 e më vonë... Por, tregimin për hoxhën e Keqekollës e kisha dëgjuar edhe nga një plak që vinte në odën e babait...

S. M.



Reserve your date now on +355 69 80 30 888
Adress: "George W Bush", Tiranë, Albania

 /thecrown_tirana

Pakkush ia di vlerën **Shalës së Bajgorës!**

Bajgora është fshati më i madh rural në tërë Shalën e Bajgorës. Problemet me rrymë gjatë dimrit dhe bllokimi nga bora, mbetën dy problemet më të rënda për banorët e kësaj ane.



Asfalti rrugor që çon në fshatin Bajgorë e më lart lidhë dy rajone masive: Bajgorën dhe Llapin. Nga moteli "Dodona" deri në Podujevë janë 22 kilometra, ndërsa po nga ai motel për në Mitrovicë janë 18 kilometra. Rruga rreth gjigantit "Trepça" në Stan Tërg gjallëron me automjete që vijnë e shkojnë nga fshatrat e Shalës së Bajgorës kodrave të larta. Atje ku dimri vjen me herët se në vendet më ulëta, pra në rrafshin e Mitrovicës.

Malësorët kanë zgjatur rendet e druve të prera për shitje, ndërkohë që gjethet e drunjve përreth rrugës përpjetë kanë nisur t'i marrin ngjyrat e vjeshtës: të verdha vende-vende. Bashkëbiseduesit thonë se po të kishin qenë rrugët e mirëmbajtura për lëvizje të popullatës dhe po të ketë kushte për jetesë në këtë anë, banorët nuk do e kishin braktisur rajonin e Shalës, e që dikur ishte shumë i popul-



luar, sepse në këtë pjesë ka bazë për jetesë, madje edhe me ajër shumë të pastër.

Se fshatrat e Shalës së Bajgorës dikur kanë pasur një zhvillim të hovshëm, tregon edhe lashtësia e xhamisë së Mazhiqit.

“Kjo xhami është këtu prej kur mbaj mend unë. Këtë xhami e mbaj mend qëkur kam qenë fëmijë. Në atë kohë ishte xhami moderne dhe me kushte të mira për rite fetare dhe lutje. Por, tash edhe vetë po e shihni se si është shkatërruar?!”, thotë Veseli, nga Mazhiqi, i cili, si duket, i ka kaluar të gjashtëdhjetat. Bashkëbiseduesi ynë, po ashtu, thotë se shumica e popullatës së Mitrovicës është nga viset e Shalës së Bajgorës. Dikur ky rajon është dominuar nga burra të rëndësishëm, si, bie fjala, Ukshin Kovaçica, për të cilin është botuar edhe libër, që pasqyron punën e tij kombëtare edhe në fushën e pajtimit, e që ishte një kërkesë e kohës.

Ç’THONË BANORËT E BAJGORËS?

Shala e Bajgorës ka shumë fshatra, e që janë të banuara akoma. Jo me aq banorë sa kishte dikur, por ato janë të banueshme dhe në to ndihet gjallëri.

Shala e Bajgorës ka këto vendbanime: Trepça, Mazhiqi, Pasoma, Tërstena, Rasha, Bare, Vidishiçi, Zabërgja, Bajgora, Melenica, Kovaçica, Magjevi, Dedia, Vllahia, Kaçanolli dhe Selaci.

Në kohën e ish-Jugosllavisë këto

fshatra kanë qenë me shumë banorë dhe është zhvilluar një jetë shumë dinamike. Ka pasur kushte të mira jetësore, sepse shumica e banorëve kanë punuar në Kombinatin “Trepça”.

Por, në kohën e masave të dhunshme të Serbisë së Millosheviqit, shumica e popullatës është larguar nga ky rajon, duke migruar për kushte sociale në Mitrovicë, Vushtrri e gjetiu, e veçmas në shtetet Skandinave.

Ky migrim ka ndodhur veçmas në vitet 1989-1990, kohë kur Serbia vuri masat e dhunshme në Kombinatin “Trepça”, duke dëbuar punëtorët shqiptarë dhe duke vendosur më shumë strukturë serbe, ashtu sikur që po ndodhë edhe tash në pjesën veriore të Mitrovicës. Këtu ka punuar edhe një fabrikë për përpunimin e lëndëve lëkurore, ka pasur edhe kushte më të favorshme për bagëti.

E, në kohën e luftës, më 1999, lufta dogji e i shkatërroi në masë të madhe të gjitha shtëpitë këtu dhe popullata u largua nga ky rajon.

Mirëpo, edhe pse çdo gjë ishte e djegur dhe e shkatërruar, prapëseprapë popullata filloi të rikthehet dhe të lidhet përsëri me vendlindjen e vet. Gjatë stinës së verës popullata kthehet me shumicë dhe i punojnë tokën, kopshtet, livadhet, kurse ka edhe të atillë që merren me blegtori, e që në këtë rajon ka kushte të mira për një gjë të tillë.

Por, me ardhjen e vjeshtës, banorët e kësaj ane merren me shitjen e druve, siç i shohim edhe tash drutë e tubuara përgjatë rrugës.

DIMRIT PAK NJERËZ I GJEN NË SHALË TË BAJGORËS

Dimri në fshatrat e Shalës së Bajgorës, e në veçanti në fshatin Bajgorë, është më i hershëm se çdo kund tjetër në afërsi të Mitrovicës. Bora fillon edhe atëherë kur fshatarët nuk e presin fare dhe e vështirëson jetën këndej pari. Së pari, bora bllokton qarkullimin normal të popullatës për në qytetet që i kanë më afër, bie fjala, Mitrovicën e Podujevën, por problem serioz paraqet edhe defektet në linjat e rrymës, për shkak të trashësisë së borës. Në këtë mënyrë, pra, dy gjërat kryesore që i përmendëm, pamundësojnë që popullata në këtë rajon të jetë stabile. Shembull, në fshatin Bare në vitin 2003 ishte fabrika e qumështit dhe e grumbullonte qumështin. Por, u mbyllë shkaku i mos stimulimit të këtij produkti dhe të importit të qumështit nga jashtë.

ÇKA MUND TË PËRFUNDOJMË?

Me të gjitha bukuritë gjatë verës, por edhe me të gjitha vështirësitë që paraqiten gjatë kohës së dimrit, Shala e Bajgorës, me rreth 20 fshatra, mbetet atraksion i rajonit që po zgjon interesimin e investitorëve vendorë e të huaj, si një vend rural i përshtatshëm për blegtori e fabrika bylmeti.

E, i njëjti interesim është edhe për ata që e duan natyrën, ajrin e pastër. Andaj, turizmi në këtë anë ka nisur t’i marrë hapat e parë zhvillimor.

Safet Krivaça



NUHA GMBH, rrugëtim sukcesi dhe krenarie në fushën e afarizmit të diasporës shqiptare në Gjermani

Gani Nuha në panairin e Köln-it / Köln Messe në prani të bashkëpuntorve dhe stafit të firmës përshëndeti kryesin e Unionit të Bizneseve, gjatë se cilës njoftoj për rrjedhjat e punës së ndërtimit të projektit me të madhë në Gjermani.

Mediumet vendore këtë projekt, pas përfundimit të ndërtimit, e cilësojnë si panairi më i madhi në botë i ndërtuar brenda një qyteti deri tash.

Sa për ilustrim të shkurtë, projekti i cili bartët dhe udhëhiqet nga Nuha GmbH, përmban volumnin e ndërtimit me 14440 kubik betonimi, 3319 tonë armatur dhe 60962 metra katror 'Schalung'.

Firma Nuha GmbH shquhet si firma lidere në fushën e ndërtimit në republikën e NRW s dhe me përtej.

Gjithashtu ishte ndër firmat e para të themeluara në diasporën shqiptare,

e cila punëson një stafë qindra punëtorësh dhe poashtu ju ofron punë dhe tjera firmave tjera shqiptare të kësaj ane.

Ndërsa Gani Nuha, përpos kontributit të lartë përmendur si firmë, jepë kontribut të jashtëzakonshëm në komunitetin shqiptar dhe posaqërisht si nënkryetar në Unionin e Bizneseve në Gjermani.

Firmës Nuha GmbH, stafit, bashkëpuntorve dhe posaqërisht nënkryetarit tonë në UB, Gani Nuhës ju urojm rrugëtim të metëjshëm sukcesi, e cila na bën krenar neve dhe gjithë diasporën shqiptare në Gjermani.





Kryetari Aliu takohet me drejtuesit e Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane në Düsseldorf

Mërgata, po përfaqëson vendin gjithnjë e më lartë e dinjitetshëm si në biznes, përfaqësim politik e shoqëror në këto vende, art dhe kulturë e kudo në lëmi tjera, thotë Kryetari i Ferizajit, Agim Aliu, gjatë vizitës në Dusseldorf të Gjermanisë, tek takohet edhe me drejtuesit e Unionit të Bizneseve Shqiptare-Gjermane.



Kryetari Veliu ,këtë rast e shënoi edhe në rrjetin e tij social, i cili në mes tjerash thekson:

Kënaqësi e veçantë të vizitoj bashkatdhetarët tanë ndërmarrës në kuadër të Unionit të Bizneseve Shqiptare- Gjermane në Düsseldorf të Gjermanisë, prirë nga kryetari i Unionit, Nazmi Viqa, sekretari Nexhmedin Veliqi, drejtorin financiar dhe anëtarin e kryesisë,

Vllaznim Kelmendi si dhe drejtorin ekzekutiv operativ, Fadil

Abdullahu, biznese këto që me punën e përkushtimit e tyre, janë referencë e profesionalizmit në rajonet e shtetet ku veprojnë.

Kemi mirëpritur dhe mirëpresim investimet nga mërgata, duke ofruar gjithë potencialin e nevojshëm, për të mundur zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Pse çdo ditë po ndodh nga një dhunim në Kosovë?

Muaji shtator është muaji më i përfolur për dhunime në Kosovë. Tri sosh kanë kaluar çdo limit dhe janë vënë në pranga dhunuesit. Pesë për një dhunim të një 11-vjeçare, plus disa të tjerë për dhunim të së njëjtës gjatë muajit qershor; një e mitur 13-vjeçare dyshohet se është dhunuar në Istog e një 14-vjeçare në Klinë.

Kohëve të fundit kanë ndodhur aq shumë dhunime në Kosovë sa njeriu duhet ta pyes veten:

Çka po ndodh në vendin tonë me kaq shumë dhunime të të miturave?

A ka dorë këtu pedofilia apo ka dorë psikopatia njerëzore, që u duken se edhe sytë e të miturave nxisin botën e meshkujve të moshës së rritur dhe të shtyrë?

Kush dhe pse po dhunojnë në Kosovë, është pyetje që duhet shtruar ekspertëve psikiatrikë, por edhe psikologëve.

Por, pa marrë parasysh, dhunimet në Kosovë duhet të marrin dënimin e merituar. Prokuroria dhe gjykatat duhet ta zbatojnë ligjin me përpikëri. Zbatimi i ligjit është crucial në parandalimin e veprave të tilla kriminale, e që rrezikojnë jetën e të rejave, duke rënë viktimat të meshkujve të pamëshirshëm e pa ndërgjegje njerëzore.

Po ashtu, shteti me masa ndëshkimo-



re të ligjit në fuqi duhet t'i analizojë shkaqet pse po ndodhin kaq shumë dhunime në Kosovë...

A janë femrat ato që i nxisin dhunuesit, edhe pse dhunimi nuk ka justifikim, ashtu siç nuk ka justifikim asnjë lloj dhune tjetër?

A ka vend për kritikë edhe edukata e pamjaftueshme familjare mbi fëmijët me moskujdesin adekuat prindëror ndaj të miturave që, realisht, në moshë shumë të reja fillojnë me bartjen e veshjes provokuese në vende publike?

A duhet të definojë më shumë shteti te veshja, e cila punë mund të qartësohet përmes shkollave ku janë të miturat?

Gjithashtu, shkolla duhet të luajë rolin edukativo-arsimor se si të vishen femrat e moshave të reja, për hir të mos-nxitjes së situatave provokuese, edhe pse dhuna nuk ka arsytim. Dhe, për të gjitha këto dukuri duhet të bashkëpunojë sistemi ndërshtetëror përmes institucioneve ekzistuese.

Ligji ekziston, andaj lypset vetëm zbatimi ndëshkimor i atyre që bëjnë krim. Në këtë rast po flasim për krim në dhunime, veçmas ndaj të miturave, dukuri kjo që po lë pasoja te viktimat që duhet të shkollohen, ta gjejnë fatin e jetës, të bëhen nëna dhe të krijojnë familje.

S. Murturi

100% tourist
CAMPING



Adresa: Shtoj, Ulqin www.touristcamping.me Tel: +38269336233 [/touristcamping_giovannisbeach](https://www.instagram.com/touristcamping_giovannisbeach)



Giovanni's Beach
COPACABANA



Adresa: Shtoj, Ulqin www.touristcamping.me Tel: +38269825858 [/giovannis_beach_montenegro](https://www.instagram.com/giovannis_beach_montenegro)

Mu kënaq zemra që gruas sime po ia ndalin rrogën!

Pse u bëmë tepër të mençur, duke menduar se vetëm ne e kemi mirë? Mendojmë edhe për atë se mund të jetojë njeriu njëqind vjet si fëmijë dhe të vdesë me po atë bindje se nuk ishte më shumë se një fëmijë gjatë gjithë jetës!

Për të dëshmuar se dikush është fëmijë gjithë jetën, duhet të flasim për disa politikanë e deputetë tanë!

“Shpikësit e Amerikës”, siç po i quajnë disa politikanë tanë, po i kërcënojnë grevistët se nuk kanë për të marrë paga ata që gjenden në grevë!

Dhe, reagan grevistët, sindikalistët, por kot, sepse Hekuran Murati i famshëm i do listat e atyre që nuk po punojnë, që po bëjnë grevë, në mënyrë që t’i ndëshkojë në zvogëlimin e pagës!

Sidoqoftë, deri më tani askund në botën demokratike nuk më ka rënë të dëgjoj a lexoj se janë ndëshkuar me zvogëlim të pagës grevistët.

Edhe kryesindikalisti i Shqipërisë, Nevruz Kaptelli, habitet me atë se ç’po ndodh në Kosovë. Ai thotë se kudo në botë qeveria i dëgjon dhe i respekton kërkesat e punëtorëve të arsimit, kurse në Kosovë ata injorohen!

Ndërkaq, kryeministri ynë, derisa nuk ishte kryeministër ishte plotësisht sindikalist. Ishte me mjekët, ishte me punëtorët, ishte me pensionistët, ishte me veteranët e luftës. Shkurt, ishte me klasën punëtore kundër

sundimtarëve...

Dhe, një i tillë ishte si personazhi i Migjenit në poezinë “Të lindet një njeri”.

Por, qëkur u bë kryeministër, nisi t’ia shtrëngojë dhëmbët popullit!

E, populli ka mbetur pa tekst! Siç thuhet në popull – si patat e egra në mjegull!

Dhe, kur u dha lajmi se do ndëshkohen grevistët, paksa më erdhi mirë shkaku i inatit që kam në gruan. Sepse, ajo në zgjedhjet e fundit e votoi “Vetëvendosjen”. E tash, mu ajo “Vetëvendosje” po ia zvogëlon pagën!

PSE VENDOSA TË JETOJA ME UNIN TIM?

Ata që i doja, pra të PDK-së vetë më prem-tuan kandidaturën për deputet, por edhe vetë më vunë postbloqe në rrugë!

Disa të tjerë, e që nuk i kam përkrahur kurrë, më ftuan të më kandidonin. Por, nuk pranova.

Dhe, mbeta vetëm me dy bashkëmendimtarë: Një ish- dashnore, e që më nuk qonte peshë, si dhe me një dost me qëndrime anti-VV, por që nuk merret me politikë.

I SHIHJA NË ENDËRR KAH MË IRONIZONIN!

Dhe, duke menduar se nuk ishte më koha të merresha me politikë, u tërhoqa tërësisht nga menyja politike.

Nuk flisja, nuk shkruaja, nuk merresha fare me komente politike...

Një natë, në ëndërr një njeri i njohur me mjekër ma zuri rrugën, derisa flisja me një berber.

I ngriti grushtet, duke brohoritur pas meje me fjalët e fëmijërisë “Kërrë kaka nati, a po të vjen inati!”...

Heu, Zot, thashë me vete, të bie më mirë shahadet se këta nuk dinë të ndalen!

Sepse, kushdo që mendon ndryshe, këta i turren dhe duan t’ia nxjerrin sytë...

Dhe, sonte nisa ta fërkojë mjekrën kur gruaja më tha se ka mbetur ndërmjet dy zjarreve: as nuk është të punojë, por as të bëjë grevë, sepse do ia ndalin rrogën.

Dhe, fjalët e saj ma bënë zemrën mal.

Madje, ka kohë që nuk jam gëzuar më shumë!

Sokol Murturi



Official authorized distributor @jamber.eu for Europe
and the Balkans allureproducts.al

 /allureebeauty



Ka diçka që ju gëzon edhe kur jeni të lënduar, por ka edhe diçka që u lëndon gjatë gëzimit. Ka diçka që u bën me lot nga e kaluara pikëlluese, por ka edhe diçka që u gëzon edhe kur jeni me lot pikëllimi.

GËZIMI DHE LOTËT PËR NGJYRAT E SYVE

Nuk ngopesha me kureshtjen rreth universit. Bija natën mbi barë të oborrit dhe shikoja yjet në qiell. Lëvizja e tyre më kishte vënë në gjumë sa e sa herë. E, nëna më

Pse kur të tjerët qeshin unë qaj?

merрте e më vendoste në shtratin e dhomës së shtëpisë së vjetër. Por, kureshtja vazhdonte për gjithçka. Ndalesha në pasqyrë dhe e shikoja veten. Dukësia mu si këlyshi i vogël, tek kafeneja ku pimë kafënë e mëngjesit. Këlyshi i vogël e shikonte veten në xhamin e ndërtesës dhe i hidhej xhamit për ta kapur këlyshin andej xhamit. E, i vetmi dallim nga kjo storie ishte se unë nuk i sulesha xhamit të pasqyrës për ta prekur vet-veten... Por, pasdite më kishte kapluar

nostalgjia për të kaluarën. Takova shoqen e nënës dhe ajo nisi të qante për shoqërimin që kishin pasur me nënën time. Tregoi një storie, pastaj një tjetër dhe, në fund, më bëri të qaj edhe unë. I mallëngjyer nga tregimet rashë të flija. Gjumi i parë më lidhte me pasqyrën. Ishte diçka në mesin e të gjitha mallëngjimeve. Isha ndalur pranë pasqyrës në banjë. Doja të rruhesha, por edhe t'i pastroja dhëmbët. Po, i thashë vetes, sa shumë i kam ruajtur dhëmbët... Dhe, kam të

drejtë të mburrem, sepse këtë më parë ma kishte thënë edhe një doktoreshë.

I shikova dhëmbët, por mendja më vajti tek njerëzit që në fëmijërinë time flisnin për sytë e mi.

Dhe, me kalimin e kohës, nuk kisha pasur kohë të shihja nëse sytë e mi kishin atë magnetizmin që ma kishin thënë dikur.

Sa budalla jam bërë, fola vetë me vete. Thellova shikimin në pasqyrë, për të gjetur ngjyrat e dikurshme, por nuk i pashë.

A thua, do të jenë tretur?

A thua, do të jenë shlyer?

Megjithatë, nuk pajtohem të mos bindem nëse janë ende ngjyrat e syve të mi, apo, vërtet, kanë ikur nga sytë e mi...

Ndoshta ngjyrat në sytë e mi janë ende, por unë nuk po i shoh, i thashë vetes. Por, për këtë kam zgjidhje. I marrë syzet, i vendosi mbi sy dhe i drejtohem pasqyrës. Oh, Zot, ja ku janë ngjyrat e syve! Të gjitha qenkan aty, por unë nuk i shihja pa syze!

E, nëse nuk i shoh ngjyrat e syve të mi, çka mund të shoh tjetër?! Dhe, në çast më rrodhën lotët...

Por, i gëzuar isha që i pashë ngjyrat e syve të mi në pasqyrën e banjës. E, i vetmi dallim është se tani ngjyrat i shoh përmes syzave dhe lotëve.

SI E LAGA ME LOT TORTËN E DITËLINDJES?

Ndërrova krahun dhe sapo desha të vazhdoja gjumin, mu mbushën veshët zile. U ngrita dhe u ula në shtrat. Nuk di nëse më kishin bërë veshët, apo do të ketë qenë diçka e mbetur nga fëmijëria? U shtriva sërish në shtrat, me dëshirë ta shihja nënën në ëndërr, me dëshirë që t'i shihja yjet në qiell.

Nuk di, mendova sërish, por mirë është ta lë veten në duart e "qerres së gjumit" dhe ajo t'më shëtis maleve e fushave. Mirë do të ishte që kur të shkonim te "lumi i fëmijërisë" të ndalojë qerrja, për ta

dëgjuar gurgullimën e lumit tim, të përjetoja rrjedhjen e ujit. Por, ndërkohë, nga mjegulla doli Drini me tortë në dorë. Vinte ngadalë, e pas tij edhe disa fëmijë të tjerë. Mbanin në duar xixa dhe numra dhe këndonin këngën e ditëlindjes.

"Kah kjo ditëlindje?!", pyeta veten. U ofruan rreth meje dhe qeshnin me mua, duke kënduar këngën: "Shumë urime për ty!"

Unë, në vend që të qeshja, heshta. Nuk më qeshej. Por, më duhej të aktroja se kinse më shkonte buza në gaz.

Vërtet, kurrë nuk kam qeshur me plot gaz. I lakmoja të gjithë ata që qesheshin me të madhe...

Sepse, mua e qeshura e madhe nuk më rri mirë në fytyrë...

Për çudi, njerëzit shumë gëzohen kur festojnë ditëlindjen! Ditëlindja u jep gëzim, kurse harrojnë se për çdo ditëlindje më afër e kanë vdekjen se kurrë më parë...

Dhe, e marrë thikën ta preja tortën dhe më ranë lotët mbi tortë.

Thashë: Janë lot gëzimi...

I gënjej fëmijët se të gjitha vitet e jetës sime kanë qenë të mira, por kësaj ditëlindje i mungon dikush që e dua shumë...

E, tek qaja, erdhi ajo...

Fill pas kësaj, hetoj dorën e gruas sime, e cila më lëkundë që t'më del gjumi, sepse kisha filluar të dënesja, të lëshoja zëra pa lidhje...

LOTËT FESTIVË...

Qëndrova pakëz ulur dhe ndërrova anën e jastëkut. Pas pak më zuri gjumi sërish, i ngarkuar me mal-lëngjim e lot.

Dhe, vjen edhe nata festive. E, kur vjen ajo natë, askush nuk mendon se do të vazhdojë jeta tutje, askush nuk di se do të rriten brengat dhe jeta do merr një trajtë edhe më të lakuar...

Isha liruar nga gjithçka. Më nuk kisha lot për jastëkun, e as për shpirtin tim të lënduar. Nata e fundvitit do të më relaksonte. Do të pija një gotë verë të kuqe, e, më pas, edhe një tjetër dhe çdo gjë do të bëhej rrafsh...

S. M.

ARAMERAS

BEACH RESORT

BOOK YOUR
VILLA NOW

+355 68 600 5041

@aramerasresort

KEPI SKALES, KSAMILL
ALBANIA

Arameras, margaritari më i shkëlqyeshëm i bregdetit Shqiptar, pika më e afërt me ishullin e Korfuzit. Një plazh fantastik me rërë të imët dhe gurë të çdo lloji ngjyre që plotësojnë tablonë joniane me blunë e theksuar të detit të Ksamillit.



BOOM

*Pse u nda
Robert Boja
nga gruaja*

*A ka burrë
për Beniaden*

*Eliza Hoxha
thotë se nuk ka
dashuri perfekte!*

*Dibran Tahiri,
70-vjeçari me stil*

*Afërdita Dreshaj
nuk ishte
edhe aq e bukur
në adoleshencë*

*Pse Adelina Berisha
i shfaqë shumë
të pasmet*

*Pse kanë pasur
zënka dikur
Sinan Vllasaliu e
Sabri Fejzullahu*

Rita Ora
e dridh Tiranën!

Rita Ora

e dridh Tiranën!



Këngëtarja e njohur me origjinë shqiptare, Rita Ora, i është përgjigjur pozitivisht ftesës së Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Erion Veliajt për të mbajtur një koncert madhështor në kryeqytet. Koncerti është mbajtur në sheshin “Skënderbej”, në mbrëmjen e 6 shtatorit, për të festuar Tiranën si “Kryeqytetin Evropian të Rinisë 2022”.

Hyrja ishte falas për të gjithë.

Lajmin e ka bërë të ditur vetë këngëtarja Rita Ora, përmes një postimi në rrjetet sociale.

“Jam shumë e emocionuar dhe e nderuar që rikthehem në Tiranën time të dashur. Erion Veliaj më ftoi të performoj në koncertin falas për të gjithë, për të festuar së bashku vitin e Tiranës – “Kryeqyteti Evropian i Rinisë”.

Rita edhe një herë ka dëshmuar potencialin e saj të jashtëzakonshëm në skenë, duke e dridhur atë dhe duke e ekzaltuar një publik të tërë me performancë të jashtëzakonshme.

Ndryshe, Tirana është “Kryeqyteti Evropian i Rinisë për 2022”, titull që jepet nga Forumi Evropian i Rinisë, i krijuar për të fuqizuar të rinjtë, për të nxitur pjesëmarrjen e të rinjve dhe për të forcuar identitetin evropian.

D. H.





Pse u nda **Robert Boja** *nga gruaja?*

Robert Boja njihet si gazetar shumë simpatik, i zoti në profesion dhe i afërt me teleshikuesit në emisionet tij "live" në televizion.

Dhe, për të është shkruar dhe shkruhet përherë.

Është shkruar edhe për jetën e tij private shumë herë dhe është thënë se Roberti dhe gruaja e tij, Gëtoarbë Mulliqi, janë çift për lakmi.

Ata janë prindër të një vajze.

Por, sipas një lajmi që u dha, çifti janë ndarë.

E, psenë e dinë vetëm ata...

A ka burrë *për Beniaden?*

Beniada Nishani, manekine dhe pjesëmarre deri në fund në spektaklin "Big Brother Albania" është shumë e pranishme në mediet tona, e sidomos në ato të Shqipërisë.

Është folur e shkruar shumë se nuk është në lidhje dashurie, por në një emision të fundit sikur u zbulua lidhja e saj me një avokat në Itali. E, cili është ai, mbetet të bëhet publik emri i tij...



Plakemi shpejt – mençurohemi vonë!



LUMTURIA ËSHTË RRUGËTIM, JO DESTINACION

Mos prit të mbarosh universitetin, të dashurohesh, të gjesh punë, të martohesh, të kesh fëmijë, ta shohësh veten të sistemuar, t'i humbësh ata dhjetë kilogramë të tepërt...

Lumturia është rrugëtim, jo destinacion.

Puno sikur të mos kesh nevojë për para, dashuro sikur të të mos kenë lënduar kurrë, kërce sikur të të mos sheh njeri!

Kujto se lëkura rrudhet, flokët bëhen të bardhë dhe ditët bëhen vite...

Por, kryesorja nuk ndryshon: Forca dhe bindja jote nuk kanë moshë. Shpirti yt është ai që largon tutje çdo ngatërresë që mund të jetë krijuar në të.

Pas çdo fundi ka një fillim të ri.

Pas çdo arritjeje ka një sfidë tjetër për t'u kapërcyer.

Përderisa je gjallë, ndjehu i tillë. Shko përpara edhe kur të gjithë presin rrëzimin tënd!

ME KALIMIN E KOHËS KUPTOJE SE...

...të rrish me dikë, sepse vetëm të ofron të ardhme të mirë, do të thotë se herët a vonë do të kthehesh në të kaluarën tënde.

...vetëm ai që është i aftë të të dojë me gjithë të metat, pa pretenduar të të ndryshojë, mund të të dhurojë lumturinë që dëshiron.

...nëse dikush rri në krahë të dikujt vetëm për të shoqëruar vetminë e tij, atëherë do të përfundojë duke mos dashur ta shohë më atë person.

...miqtë e vërtetë vlejnë me shumë se ç'do sasi parash.

...miqtë e vërtetë numërohen me gishta dhe ai që nuk lufton për të ruajtur miqësinë e tyre, herët a vonë do të përfundojë i rrethuar me miqësi të rreme.

...fjalët e thëna në një moment, në ikje e sipër, mund ta lëndojnë personin tjetër gjatë gjithë jetës.

...çdo eksperiencë e jetuar me ç'do person është e papërsëritshme.

...ndërto gjithçka mbi të sotmen, meqë e nesërmja është shumë e pasigurt për të bërë plane.

"Njeriu plaket shumë shpejt dhe mençurohet shumë vonë. Tamam atëherë kur nuk ka më kohë".

Nuk e di kush e ka thënë këtë, por më duket gjeniale.

Personazh

Eliza Hoxha thotë se nuk ka dashuri perfekte!

Eliza Hoxha është emër i njohur prej vitesh. Këngëtare që e duan dhe e pëlqejnë të gjithë.

Eliza nuk është nga këngëtalet e zakonshme. Muzika e saj është e thellë, me mesazh.

Eliza është artiste dhe promovon art të mirëfilltë. Pëlqen fotografinë, është arkitekte, politikane dhe këndon, ani pse viteve të fundit sikur e ka "braktisur" muzikën.

Eliza Hoxha është femër e fortë dhe për këtë admirohet.

Artistja shumëdimensionale ka shije ndryshe, edhe në art, por edhe në arkitekturë, profesionin e saj të vërtetë.

U diplomua në vitin 2002, në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Universitetin e Prishtinës. Shkollimin pasuniversitar e kreu në Universitetin "Leuven Katholieke" (Universiteti Katolik i Leuvenit) në Belgjikë.

Eliza në punën e saj si arkitekte çdo herë ka arritur suksese. Është arkitekte e zonja dhe nuk e lë anash profesionin e saj, për të cilin edhe ka studiuar. Ndryshe, Eliza është ligjëruese në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës.

Personazhi i sofistikuar i skenës, së fundi, po flet më shumë për arkitekturë e politikë sesa për muzikë.

NJË KARRIERË PA "BOZË"

Sa i përket muzikës, këngëtarja sikur po rri "e heshtur", megjithatë Elizës asnjëherë nuk i dihet. Ka dëshmuar se di të sjellë këngë që godasin.

Mjafton të kujtohen vetëm disa nga këngët e saj dhe të bindemi se ajo është këngëtare hitesh.

Eliza gjithmonë ka dëshmuar se nuk di të bëjë gjëra të thjeshta, nuk di të krijojë "bozë".

DASHURIA SIPAS ELIZËS...

Sa i përket jetës private, nuk flitet për diçka të re. Eliza ndihet rehat kështu siç është.

"Jam e prirë që jetës t'i qasem pozitivisht, e, po ashtu, edhe relacioneve, pavarësisht zhgënjimeve që më kanë përcjellë deri tani. Jeta është shumë më e bukur dhe ka kuptim kur mendon e kujton momentet e bukura dhe kur bën gjëra të bukura", ka thënë këngëtarja.

"Dashuri perfekte nuk ka, por perfeksioni mbështjellë një dashuri atëherë kur e adhurojmë dhe e dashurojmë personin tjetër me gjithë anët e mira dhe të këqija që ka. Sepse, tek atëherë dashurojmë sinqerisht".

N.



Dibran Tahiri, 70-vjeçari me stil

"Familja Moderne" ka përfunduar prej vitesh, por jo edhe kureshtja për aktorët ikonë të këtij seriali vendor. Një nga karakteret më të pëlqyer të audiencës ka qenë ai i "Dinit", kryefamiljarit paqësor të "Familjes..." më moderne në ekran.

Sot aktori, Dibran Tahiri, jeton qetë dhe zgjedh me kujdes rolet që dëshiron t'i luajë.

Aktorin e karakterizon stili dhe mënyra e veçantë e të veshurit. Gjithmonë duket në hap me kohën...

Dibran Tahiri, ndonëse në të 70-at, ka lidhje edhe me teknologjinë, madje është mjaft prezent edhe në rrjete sociale me foto e mbishkrime.



Afërdita Dreshaj *nuk ishte edhe aq e bukur në adoleshencë*

Vite me radhë konsiderohet si një nga femrat më të bukura të shou-bizit shqiptar.

Por, a ka qenë e bukur gjithmonë?

Afërdita shprehet se nuk i ka pëlqyer vetja dikur.

Ajo, në fëmijëri e adoleshencë, ishte brune, me vetulla e buzë të holla.

Vite më pas Afërdita Dreshaj u shpall "Miss Universe Kosova" dhe ka pasur një karrierë të bujshme në modelim dhe muzikë.

Pse Adelina Berisha i afirmon shumë të pasmet?

Është rritur në skenë, e kanë dashur e adhuruar të gjithë bashkëmoshatarët e saj.

Megjithatë, nëse dikur e donin për talentin dhe brishtësinë, sot e duan dhe e shikojnë edhe për të pasmet, të cilat i ekspozon kudo.

Adelina thuhet se në të gjitha fotografitë dhe videoklipet e saj më shumë se çka do tjetër e shfaqë prapnicën, të cilën e ka pikë të dobët dhe, njëkohësisht, "armë të fortë".

Kujdes: Ajo vret!



Pse kanë pasur zënka dikur Sinan Vllasaliu e Sabri Fejzullahu?

Prej vitesh ndajnë të njëjtën skenë dhe u gëzohen sukseseve e arritjeve të njëri-tjetrit.

Sabri Fejzullahu dhe Sinan Vllasaliu nuk janë të një gjenerate, por i bashkon arti, muzika, kënga...

Thuhet se askush nuk e njeh më mirë Sinanin sesa Sabriu dhe e kundërta.

A kanë pasur zënka ndonjëherë?

Në fakt, ka pasur disa herë ftohje në marrëdhëniet e tyre, por ata janë pajtuar sërish, duke u kthyer gjithmonë e më të fortë. Por, arsyeja pse kanë pasur zënka nuk dihet...

Kush janë bashkëshortët *e prezantueseve kosovare?*



**MERITA SEKIRAQA -
MALUSHI E KA BURRIN
REGJISOR**

Merita Sekiraqa - Malushi prej shumë vitesh është pjesë e botës së medias. Ajo që nga fillimi është e angazhuar në "RTV 21", ku ka bërë disa emisione, që janë konsideruar të suksesshme. Merita për një kohë ka realizuar edhe edicionet "Edhe unë jam Kosovë", cikël i emisioneve me karakter humanitar, me ç'rast janë ndihmuar shumë familje skamnore. Ndërkohë, e kemi parë edhe në emisionet e mëngjesit dhe atë të pasdites "Bon-Bon". Merita është e martuar me regjisorin Blerdi Malushi.



**RAMIZE MURTEZI-
SHALA, GRUAJA
E ISH-DREJTORIT**

Njihet si një nga spikeret e lajmeve me qëndrim serioz, me lexim të veçantë dhe, gjithashtu, me pamje karakteristike. Por, ndër vite edhe Ramizja ka ndryshuar. Megjithatë, asnjëherë s'ka dalë nga vetja dhe nga ajo që e karakterizon. Ramizja nuk ka preferuar të rrijë vetëm në rolin e spikeres së lajmeve, andaj ka marrë përsipër edhe realizimin e një cikli emisionesh me titull "Udhëve". Ajo që disa vjet është e martuar me ish-drejtorin e televizionit publik, Mentor Shalën.



**DELFINA KRASNIQI,
E BUKURA E "RTK"-SË**

Delfina Krasniqi prej vitesh është pjesë e ekranit. Ajo udhëheqë emisionet e mëngjesit në "RTK". Por, edhe pse punon në televizion, nuk është ndër ata emra që përmenden shpesh. E, kjo duket të jetë dëshira e Delfinës, e cila e do gazetarinë e moderimin, por nuk i pëlqen të jetë e ekspozuar dhe e përfolur.

Delfina gjithmonë ka rënë në sy për sharmin e saj, ëmbëlsinë, të folurit pastër dhe me kulturë, por edhe për punën profesionale.

Edhe portreti familjar i prezantueses duket i mrekullueshëm. Ajo është e martuar me Artan Behramin.



TEL: +355698663395

Marrim porosi edhe nga jashtë Shqipërie

 /anabela_flowers

Anketë: Ç'thonë gratë e martuara?

Jetë të mirë bëjnë gratë e biznesmenëve, por problemet i kanë të mëdha!

Shumë nga gratë e rëndomta ua kanë zili atyre grave që i kanë burrat biznesmenë. Do të jepnin gjithçka që edhe burri i tyre të ishte i njohur. Por, ka edhe të tilla që nuk duan që burri i tyre të jetë i njohur, por duan të jetë i thjeshtë, punëtor, pa probleme...



V. T., 41 VJEÇE, NGA PRISHTINA:

- Jam e martuar dhe i kam dy fëmijë. Im burrë është profesor. Kurrë nuk do e merrja burrë biznesmenin. Sepse, po e shihni edhe vetë se si po zhyten ata në afëra korruptive, në dallavere me tenderë të ndryshëm, e të tjera të ngjashme. Thjesht, më pengon fama e burrit, sepse ai pastaj do e ndjej veten lart e unë do mbetëm nën hijen e tij... Shkurt e shqip: Nuk dua që burri im të jetë në qendër të vëmendjes, por unë. Sepse, po të jetë ai në qendër të vëmendjes, pa dyshim, nuk do të ketë kohë t'më përkushtohet mua, por ndonjë tjetër, me të cilën edhe e lidhë vendi i punës, udhëtimi a shoqëria. Andaj, shyqyr Zotit, burrin e kam profesor: shkon në mësim, kthehet pas mësimit te unë në banesë dhe bashkë me fëmijë pasdite dalim në ndonjë vend për të pirë kafe apo edhe në shëtitje.

S. B., 39 VJEÇE, NGA PEJA:

- Do të doja ta kisha burrin të famshëm, por kurrsesi biznesmen. Bie fjala, po të jetë biznesmen, ai do të vonohet pas punës, do dal me shokë e kolege dhe një Zot e di kur kthehet...

E, unë jam xhelozë dhe nuk do toleroja gjëra të tilla kurrë. Im burrë është mjek, punon pa ndalur, kështu që edhe punët e kemi mirë. Unë i jam përkushtuar me mish e shpirt vajzës sonë, ajo tash është 5 vjeçe: e dërgoj në çerdhe dhe vetë kthehem në shtëpi e i kryej punët e shtëpisë. Kah ora 14 shkoj në ndonjërin nga kafiteritë që ndodhen afër çerddes së vajzës, takoj ndonjë shoqe, por ka raste edhe ndonjë shok nga shkolla e mesme dhe pi kafe nja një orë a një orë e gjysmë, deri kur edhe vjen koha që ta marr vajzën nga çerdhja. Në mbrëmje mua dhe vajzën burri shpeshherë na dërgon në ndonjë restorant për të ngrënë darkë.

L. E., 43 VJEÇE, NGA FERIZAJ:

- Thënë të drejtën, ndoshta pse jam e lindur e rritur në fshat, e që nuk ishim mirë materialisht, nganjëherë më shkon mendja te ato që i kanë punët mirë dhe them lum ato që i kanë burrat biznesmenë a politikanë: kushte të mira po, shëtitje po, verës në det po, vetura luksoze po, ahengje e sorollatje poshtë e lart po. E, çka i duhet njeriut tjetër? Por, ka edhe raste që kur po i dëgjoj në televizor se si po i shajnë disa nga

politikanët tanë që po vjedhin sa po mundin, them me vete: shyqyr Zotit që im burrë është punëtor administrate dhe nuk ka çka me vjedhë se ndoshta do të bëhej si ata që i përmenda pak më lart.

Sidoqoftë, kur kthehet burri nga puna, unë dhe fëmijët (një vajzë e një djalë e kemi), ulemi bashkë dhe hamë drekë, pastaj ai shikon televizor, kurse unë i laj enët apo ndonjë gjë tjetër. Në mbrëmje, thënë të drejtën, kënaqem duke i shikuar serialet turke dhe jam mishëruar me to.

E, për dalje në dreka e darka, siç bëjnë gratë e biznesmenëve, unë nuk i kam kushtet, por nuk prish punë, edhe pse nuk dal. Shpesh me fëmijë shkoj në familjen time dhe rri nga dy-tri ditë, e fëmijët kënaqen në ajër të pastër, sepse majën e Lybetenit e kemi shumë afër.

ÇKA MUND TË PËRFUNDOJMË?

Jetë të mirë bëjnë gratë e biznesmenëve, por edhe problemet i kanë të mëdha: ku shkoi burri, pse nuk erdhi ende burri, sa do të rrijë këtë herë në udhëtim, e të tjera të ngjashme, brenga të cilat gratë e martuara me burra të thjeshtë nuk i kanë. Edhe kjo mjafton, a?

Diturie Haxhaj





Pse po më zbehen kujtimet?

Dua t'i tregoj Drinit një kujtim, por ai mendon se kujtimet janë përralla...

Motra ka ardhur nga larg e unë akoma e shoh atë me shami në kokë e sy të përlotur.

Më duket sikur jemi në natën kur ajo qante pse shkonte nuse! Më duket se më përqafova akoma me lotët e ngrohtë të motrës...

Më bien lotët mbi gjergjefin e saj që më duket e kam pranë syve, sepse ajo qëndiste shqiponjën më të bukur shumë vite më larg...

Dritarja do të mbyllej me batanije që të mos dukej drita jashtë shtëpisë.

Duhej të zvogëlohet drita edhe brenda, që të kishte errësirë të sigurt.

Motra kishte vënë kokën mbi gjergjef dhe qëndiste me gjilpërë, për ta bërë ekskluzive pamjen e pajës së nusërisë.

Ajo pak ditë më vonë do të niste të qante nën një shami që nuk do ia mbulonte sytë e përlotur. Do të vinte në mëngjes, herët në mëngjes teksa flija në shtrat, do më përqafova e mallëngjyer, e dy shoqe të saj do e mbanin përkrahësh.

Sidoqoftë, ishte koha e Rankoviqit, i cili kishte për synim zhdukjen e shqiptarëve. E, shqiptarët do të pranenin çdo lloj vdekjeje, pos të mos nënshtrroheshin e çnjerëzoheshin moralisht.

Ishte kjo një pikë e dobët e njeriut tonë me plis, por ishte edhe batanija dhe lotët e motrës që do të bëhej nuse, e ne do ta kujtonim motrën përjetë, duke pritur shtatë ditët e para të javës për ta parë sërisht në shtëpi, kur burrat do të vinin për të parën herë me dhëndrin. Dhëndri nuk do të fliste fare. Nuk do të bëzaj edhe nëse dikush do ta pyeste diçka, sepse për të do të përgjigjeshin familjarët e tij, meqë ai mund të gabonte nga turpi...

E, do të shkonte shumë kohë derisa ai të përshtatej me familjen tonë...

S.



Mandarine Restaurant by Marina Bay
+35533410000
+355696041000

Lime Lounge by Marina Bay
+355696041001
info@marinabay.al
www.marinabay.al

Adresa: Vlorë, Shqipëri

Dhimbjen time mos e përjetoftë asnjë vajzë!

Isha e re, në shkollë të mesme. Nuk them se isha shumë e bukur, ama nuk e di pse çdo djalë donte të më bënte për vete...

Edhe shumë djem më ndiqnin, unë e desha vetëm një person dhe me të i përjetova momentet më të bukura në jetë, ishte dashuria ime e parë. E njoha botën pranë tij. Ai më qëndronte pranë kudo, andaj edhe iu dorëzova me mish e shpirt. Dhe, fill pas atij akti u betua se nuk do me linte kurrë vetëm, sepse edhe kisha fikë nga vetmia.

SHOKËT E DASHNORIT TIM DONIN T'MË BËNIN PËR VETE!

Edhe pse isha e lumtur me Otin (kështu e thërrisja shkurt), shokët e tij nuk më linin rehat, sepse secili prej tyre dëshironte të më kishte për vete...

Por, kurrë nuk e tradhtova, e ky qe gabimi im, sepse e dashuroja shumë... Dhe, shokët e tij, duke parë se mua nuk mund t'më përfitonin, ia gjetën atij një femër me letra në Austri dhe ajo ia rregulloi vizën dhe shkoi atje, e që, siç kam dëgjuar, janë martuar... Në "Facebook" hedhë foto me të, duken të lumtur, të hareshëm, të gëzuar...

Një ditë në "Facebook" i shkrova, i thashë ku e la betimin se nuk do më linte, por ai ma ktheu se betimi ishte për kohën sa ishim bashkë, e jo edhe tash...

Dhe, meqë e di se ai i lexon këta rreshta, i them se kurrë nuk e tradhtova, andaj edhe nuk ia bëj hallall dhimbjen

që ma ka shkaktuar.

Prandaj, dhimbjen që ma ka shkaktuar ai kurrë mos e përjetoftë asnjë vajzë, sepse ne, të gjorat, s'kemi faj pse Zoti na takon me njerëz të pabesë!

I DASHURI I TASHËM MË SHANË!

Sidoqoftë, më vonë njoha një djalë tjetër, por ky më maltreton, më shanë, e unë e duroj. Sepse, si 30-vjeçare që jam tash dhe jo e virgjër, më s'di kah t'ia mbaj...

S'më ka mbetur tjetër pos t'i dorëzohem kujtdo që më del në rrugë, i ri a i vjetër, sepse jeta ime e ka marrë teposhtën...

Velina S.



Boat Trip
Don't forget this summer!



 /canyonmatka_

TEL: +38970726265

Cilët këngëtarë shpejt u afirmuan e rrallë përmendën?

Është interesante se disa këngëtarë shpejt u afirmuan, por rrallë përmenden. Këtë herë po i zëmë në gojë dy prej tyre: Haxhi Maqellarën dhe Malësorin. Por, nuk janë të vetmit...

HAXHI MAQELLARA

Haxhi Maqellara është këngëtar i njohur. Veprimtaria artistike më e shkëlqyer e tij pasqyron periudhën e viteve 80, kur lëvizja kombëtare kishte marrë hov për çlirimin e Kosovës. Prandaj, edhe motivi patriotik merr me këngët e tij një tingëllimë kushtrimi e aktual.

Nga ana tjetër, në repertorin e tij gjeti shprehje atmosfera e dasmës dibrane, përshkrimi i dashurisë rinore, mbi të gjitha malli i mërgimtarëve.

Haxhiu, me veprimtarinë e tij artistike, konsiderohet themeluesi i një rryme të re muzikore, e cila sot e kurdoherë gjen vend në vatrat shqiptare.

Ka kënduar më shumë se 40 vjet vetëm këngën folklorike dhe popullore, që si thotë ai, të pastër dhe me taban shqiptar. Haxhiu është këngëtar i që ka marrë deri tani dhjetëra çmime dhe mirënjohje nga Kosova, Dibra e Madhe, Peshkopia, Tirana dhe shqiptarët e Amerikës.

E ka filluar karrierën në qytetin e lindjes, në Dibër, si anëtar në Shoqërinë Kulturore Artistike "Liman Kaba", më pas e ka vazhduar në Ansamblin "Ibe Palikuqi" në Shkup.

Ka realizuar disa albume: "T'faleminderit moj Tiranë", vitet 80, më pas "Jam arshik" 2008 dhe i fundit "Nana ime" 2013.

Tash jeton dhe vepron në Amerikë.

Por, që nga viti 1980 më nuk është aktiv në Kosovë dhe as që përmendet se ka kënduar ndonjëherë!



MALËSORI

Malësori këndon, kryesisht, këngë popullore moderne dhe folklorike. Është këngëtar i njohur shqiptar nga Trieshi, nga Malësia e Malit të Zi, ku ai jetoi dhe u rritë, e që shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Podgoricë.

Emri i tij i plotë është Malësor Prënkoçaj.

Ishte anëtar i grupit folklorik "Besa" nga Trieshi, ku ishte i njohur si këngëtar e instrumentist i çiftelisë dhe sharkisë.

Malësori studioi në Prishtinë, ku edhe u angazhua si këngëtar dhe pat shumë këngë hite. E, ndër to prinë kënga "Kthehuni", me të cilën edhe mori pjesë në VFM 2003 dhe kështu me radhë. Këngën që e publikoi në mars të vitit të sivjetmë mban titullin "Hyjnesha" dhe është punuar me videoklip.

Por, edhe për Malësorin ka vite që nuk flitet e as që shkruhet gjë...





DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE



Vjehrra më përgjon prapa derës kur kam marrëdhënie me burrë!

E dashura Redaksi, jam në hall të madh, sepse e kam kuptuar se vjehrra më përgjon pas dere kur kam marrëdhënie seksuale me burrë.

E, nga biseda që kam bërë më burrë në dhomën e fjetjes e ka kuptuar se herën e parë s'kam pasur shenja t'kuqe...

Jam nga rrethi i Ferizajt. U fejova 17 vjeçe, kurse u martova posa i mbusha 18, sepse i fejuari im nuk donte më t'më linte në fshat.

Por, gjatë kohës njëvjeçare sa isha e fejuar, mësova çfarë ishte mashkulli, sepse deri në atë kohë nuk kam pasur punë me asnjë mashkull.

Dhe, kur u martuam, të nesërmen në mëngjes çarçafët ishin të pastër, pa shenja gjaku...

VJEHRRRA MË THA: "A NUK KE QENË E VIRGJËR, A?!"

Gjatë aktit të natës së martesës nuk pata gjakderdhje, sepse ajo gjë ishte kryer që moti me të fejuarin tim.

E, se nuk pata gjakderdhje e ka kuptuar edhe vjehrra ime, e cila në mëngjes herët erdhi në dhomë kinse për t'i ndërruar çarçafët...

Dhe, kur pa se ata ishin të bardhë, më tha:

"A nuk ke qenë e virgjër, a?!".

"Kam qenë, por djali yt ma ka marrë që moti!", ia ktheva me nervozizëm. Por, duke mos më besuar, që nga ajo ditë vjehrra nisi me poshtërsitë nga më të ndryshmet...

"LËSHOJE GRUAN SE KJO BËN VETËM VAJZA!"

Pas një viti e gjysmë linda fëmijën e parë, si molla. Ishte vajzë.

Dhe, nga ajo kohë i thoshte tim burri:

"Lëshoje se kjo di të lindë vetëm vajza!"

Pra, mendohej t'më ndante nga burri...

E, nuk vonoi shumë dhe burri im nisi të sillej, vërtet, keq ndaj meje.

Madje, një ditë ia zura mesazhet në

telefon me një femër të panjohur për mua dhe ia tregova vjehrrës.

Por, ajo më tha se nuk beson se djali i saj bën gjëra të tilla...

Atëherë, të njëjtën femër e mora në telefon dhe ia dhashë vjehrrës të fliste me të.

Dhe, pas disa fjalish që i ndërruan, e kuptova se të dyja bënin pislleqe, se të dyja kishin për qëllim t'më ndanin nga burri...

Madje, me kohë e kuptova se vjehrra kishte qenë edhe te një magjistare, që t'më bënte magji.

Mirëpo, çka do që më bënte nuk e kundërshtoja, sepse me kohë e kuptova se ajo dhe dashnorja e burrit kishin për qëllim t'më ndanin nga burri.

E, unë e doja burrin dhe nuk bija në grackën e tyre...

Dhe, as që do të bije...

Sevda, Ferizaj



PARA

PAS



20 SEANCA

-13 KG

Qendrat e dobësimi 'Shkenda Dubova' janë ndër bizneset më të suksesshme të vitit. Duke filluar me një degë të vetme në Prishtinë, biznesi i Shkendës sharmante, ka kaluar kufijtë kosovar. Tani, qendrat e dobësimi gjenden edhe në Shqipëri, Gjermani dhe Zvicër, e njëkohësisht pritet që të hapen edhe nëpër vende të tjera të botës.

Gjithsesi, suksesi i tillë vjen si rezultat i punës së palodhshme të Shkendës dhe stafit të saj, mirëpo edhe i shumë storjeve të suksessit, të qindra klientëve të kënaqur.

Kush thotë që një femër nuk është e denjë për biznes?

Shkenda Dubova e dëshmon të kundërtën, duke qenë shembulli më i mirë i femrës kosovare të suksesshme.

Shumë mund të pyesin se si ndodhë i gjithë procesi i dobësimi tek këto qendra, me rezultate kaq

të dukshme tek klientët? Çdo klient fillon me seancat e shkrirjes së dhjamit, përmes aparaturave më moderne, që janë në përputhje edhe me standardet evropiane të teknologjisë së dobësimi.

Kështu, klienti së pari i nënshtrohet një analize trupore, ku përcaktohen: masa dhjamore, masa hidrike, masa muskulore dhe skeletore, si dhe metabolizmi. Si rezultat i kësaj terapie, klienti humbet 5-8 kg në 10 seanca të plota dobësimi, me një reduktim të perimetrit deri në 10 cm, për vetëm 10 seanca.

I gjithë ky proces ndodhë falë këtyre aparaturave, karakteristikat e të cilave do t'i shohim në vijim:

- Perfect Body-Tunnel Sauna - Është një aparaturë e teknologjisë së fundit, dhe rezultat i një projekti të gjatë kërkimor, efikasiteti i së cilës është verifikuar shkencërisht në të gjitha aspektet mjekësore e teknike, pa efekte anësore, e po ashtu, edhe kuruese për shumë sëmundje. Kjo aparaturë funksionon duke aktivizuar molekulat e ujit, që përmirësojnë thithjen e oksigjenit, qarkullimin e gjakut dhe nxisin metabolizmin. Rrezet infra të kuqe të afërta dhe të largëta, kombinohen për të depërtuar në indet e lëkurës deri në 30% (6 mm nën epiderme), duke shpërbë grumbullimin e yndyrës të lokalizuar në bark, vithe dhe kofshe. Në mjekësi, IR përdoren për shërimin e shumë sëmundjeve si: sëmundjet reumatike, sëmundjet degenerative të nyjeve, gjendjet postraumatike (kryesisht sportistët), inflamacionet e hapësirave paranazale etj.
- Body Shape-Kabina e Shtrirë - Një tjetër pajisje që sjellë benefite të jashtëzakonshme për shëndetin, e në veçanti në humbje të peshës. Kjo aparaturë realizon një funksion të rëndësishëm në relaksim dhe detoksifikimin e tyre, duke larguar toksinat dhe acidin laktik. Benefitet kryesore të kësaj aparature janë:

- Riaktivizon metabolizmin dhe ndihmon në eliminimin e shtresave të tepërta dhjamore, duke eliminuar kilogramët, dhe duke ofruar rimodelimin e formës trupore;
- Lehtëson dhimbjet nga patologji të ndryshme, si dhembjen e kurrizit, nervit ishiatik, artritin, reumatizmin;
- Rritë qarkullimin e gjakut duke furnizuar kështu indet dhe çdo pjesë të trupit, me elemente ushqyese;
- Tonifikim i thellë;
- Përmirëson shëndetin e zemrës dhe ulë stresin;
- Përmirëson sistemin nervor;
- Zhdukë në mënyrë të ndjeshme celulitin duke eliminuar shtresat dhjamore;
- Ngadalëson efektin e plakjes, duke përmirësuar dukshëm elasticitetin dhe butësinë e lëkurës;
- Përmirësim i dukshëm i drenimit të toksinave dhe i lëngjeve;
- Detoksifikim i organizmit, rritje e forcës dhe fleksibilitetit;
- Lehtëson gjendjen e depresionit;
- Efekt analgjik;
- Lehtëson dhimbjen dhe përmirëson lëvizjet te personat që kanë sëmundje reumatike, etj.

• Sauna Tradicionale nga Druri i Pishës - Është aparaturë ku përmes efektit termik të nxehtësisë, ndihmon në eliminim e shtresave dhjamore dhe humbjen e peshës. Disa nga benefitet e saunës me nxehtësi janë:

- Detoksifikim;
- Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ulë tensionin arterial;
- Humbje të peshës;
- Eliminon celulitin edhe nga zonat më delikate;
- Relaksim muskolor, etj.

• Pajisja e Dobësimi Intensiv (Ultra Sonik) - Kjo pajisje funksionon përmes valëve sonike të frekuencës 40000Hz, të gjeneruar nga sonda. Pasi valët hyjnë në trupin e njeriut, gjenerohet efekt intensiv goditës në qelizat dhjamore, si dhe lëvizje ndërmjet qelizave dhjamore, të cilat në mënyrë efektive djegin energji, dhe kështu ndodhë tkurja e qelizave dhjamore. Ndërkohë, vibrimi i valëve sonike, shkakton ndikim intensiv midis qelizave, të cilat shpërthejnë menjëherë, duke zvogëluar numrin e qelizave yndyrore dhe arrijnë efektin e heqjes së dhjamit.

• Elektrostimulorët Muscular - Ky është procesi i fundit që bëhet gjatë një seance. Është një proces shumë i rëndësishëm, përderisa jeni duke shkrirë dhjamin, përmes elektrostimulimit, tonifikohet trupi, nuk e lë të varet dhe të qullët trupi, si dhe stimulohen muskujt dhe ngushtohet perimetri.



Edhe këtë e prita...

Mbesa ime dashnorit i thotë burrë!

*Vajza e motrës, pra mbesa ime, tregon për të dashurin e vet, të cilin e
quan herë dashnor e herë burrë...*

"A e ke burrë a dashnor?", i them unë.

"Është burri", më thotë ajo.

"A jeni martuar?", e pyes.

"Jo, akoma".

"A jeni fejuar?"

"Jo, akoma".

"A ta njeh familja atë njeri, mbesa
ime?"

"Jo, akoma".

"E, si mund të jetë ai burri yt, kur ende
as nuk e njehë familja jote, as nuk ka
ndodhur fejesa?!"

"Po, ashtu tash po ndodhë".

"Jo, mbesa ime, burri është burrë
vetëm pasi të jesh martuar me të. Pasi
të kesh bërë dasmë! Pasi të jetë dhënë
dora ndër burra e ajo është dëshmia
se ti je martuar.

Sepse, pasi të jepet "teslimi", zbrazet
pushka apo alltia dhe kjo tregon se ti
je gruaja e filan burrit e ai burrë i filan
nuses. Ti po tallesh, sepse ende nuk di
ta dallosh dashnorin nga burri!

Nëna jote e di si shkohet te burri dhe
si bëhet dikush gruaja e dikujt, sepse
është martuar me dasmë".

S.

remos® KA PUNË PËR TY!



Çka ne po kërkojmë është: Pizzamen, Kuzhinier, Barista, Kamariet



Aplikuesit duhet të kenë njohuri të gjuhës
Gjermane dhe Angleze

Vendndodhja
Frankfurt, Köln, Koblenz, Wiesbaden,
Westerwald, dhe Urmitz.

Në kontaktoni në info@remos-restaurants.de



[remos_restaurants](https://www.instagram.com/remos_restaurants)

| info@remos-restaurants.de

| www.remos-restaurants.de

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depressive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

E do, e rrahë, nuk ndahen!

Zonjë, ju përshëndes nga Gjermania. Jam nënë 54-vjeçare, kam problem me vajzë. Ajo para dy vitesh zgjodhi një djalë në Kosovë për t'u martuar dhe e solli në Gjermani, duke ia bërë letrat. Me të ardhur këtu, vetëm pak muaj ishte në rregull marrëdhënia e tyre dhe ka më shumë se një vit që ai e rrahë vajzën time, e maltreton.

Thotë se e do. Por, as nuk ndahen e as nuk jetojnë rehat e në harmoni!

Po dyshoj se kanë magji, sepse edhe kur u them të ndahen nuk duan, por disi jetojnë si me inati të tjetrit. Të lutem, më ndihmo, të di, të paktën, çka është në pyetje, sepse ata me këtë dhunë që e shkaktojnë ose duhet të ndahen ose duhet ta ndalin dhunën...

"Nëna me brenga"

Përgjigje:

Zor se mund ta përballojë dikush dhunën dhe të duhet me partnerin. Dhuna është shkatërrimtare në çdo lloj dashurie apo lidhjeje, përveç nëse partnerët janë me doza

patologjike në ndjenjat e lidhjes së tyre...

Në rastin tuaj, shoh se dhëndri i ardhur nga Kosova, zor e ka të integrohet në shoqërinë gjermane, ku bëni ju jetë që 30 e më shumë vite.

Sipas asaj që shoh unë, dhëndri merr këshilla nga familja e vet që ta shtyjë sa më shumë mundësinë e jetës bashkëshortore me vajzën tuaj. E, në momentin kur i merr letrat sipas ligjit edhe të ndahen.

Pra, ky është qëllimi i tij, prandaj mirë është të sqaroheni familjarisht e të mos shkaktohet dhunë as e rastit e as e qëllimshme, sepse dhuna me pasoja mund të shkaktojë dhimbje dhe pasoja traumatike.

Prandaj, zgjidhni problemin, sepse nuk jetohej me dhunë. Në anën tjetër, e keni shtetin ligjor dhe është mirë ta kërkonti edhe ndihmën e shtetit në tejkalimin e problemit...

Problemi me nusen...

E dashura magjistare, të shkruajmë një çift bashkëshortor i moshës 56-vjeçare. Jetojmë jashtë Kosovës.

Në verën e kaluar e kemi martuar djalin, por nuk jemi të kënaqur me nusen. Nuk është punëtore, nuk zgjohet me kohë.

E kemi të vetmin djalë dhe e kemi pritur shumë këtë martesë, por duket se fati na e ka kthyer shpinën.

A do të jetojë nusja me djalin, apo do të ndahen?

(Mos i shëno emrat, të lutem, por vetëm përgjigjen na e boto...).

"Zhgënjimi"

Përgjigje:

Nusja, zakonisht, tregon aftësitë dhe kujdesin e saj në fillim martesor. Por, nëse ajo nuse as tani në fillim nuk ka treguar vlerat e veta, unë dyshoj se kjo më vonë do të përmirësohet. Megjithatë, është dëshira e tyre të jetojnë si duan. Nëse djali jeton mirë me nusen dhe nëse sjellja e saj nuk e pengon, atëherë mos ndikoni në ndarjen e tyre. Apo, mos e imitoni Nastradinin me gruan kur donin ta nxisnin vajzën e tyre të punonte.

Nastradini kishte një vajzë dembele dhe një ditë, për ta ndier turpin që nuk punonte gjë në shtëpi, Nastradini i dha një ide gruas. I tha se unë po e marrë fshesën dhe po fshij nëpër shtëpi, e ti ngrihu të ma marrësh nga dora, e vajza do të ndjehet e turpëruar pse ne grindemi për fshesën dhe do fshijë vetë.

Nastradini mori fshesën të pastrojë, kurse grua u ngritë e i tha:

"Ti të fshish shtëpinë nuk bën asses, andaj, edhe pse jam e

sëmurë, e bëj unë!”

E, derisa ata grindeshin se cili do e fshinte shtëpinë, u ngritë vajza dhe u tha:

“Është turp të grindeni para fëmijëve, më mirë ta bëni me rend një ditë ti e ditën tjetër tjetri!”

Pra, kot është të stimuloni ndonjë mënyrë për ta ndarë, sepse do varet nga djali juaj se si do të vazhdojë ai me nusen: Do e durojë, apo do e bindë të jetë e vyer...

A do të kem bashkim familjar?

Vitin e kaluar, në muajin shtator, jam kthyer nga Suedia në Kosovë. Atje kam qëndruar tetë vjet pa letra.

E patëm prishur kurorën me gruan. Gruaja, vajza dhe dy djemtë i kanë fituar letrat. Më 15 shtator 2021 kam bërë përsëri kurorëzim me gruan dhe kam aplikuar për bashkim familjar në Suedi.

A do më realizohet kjo dëshirë që të bashkohem me familjen time?

“Nga Mitrovica”

Përgjigje:

Lëvizjet tuaja familjare tregojnë qartë se keni punuar për t’i fituar letrat në Suedi. Por, gjërat janë bërë të mëdha, sa shteti tani është në përkujdesje dhe hulumtim të rastit.

Megjithatë, ligjshmëri u takon të bëheni bashkë. E drejta juaj është të jetoni si familje dhe unë shoh se do të u plotësohet kërkesa.

Pse njerëzit nuk më duan?

Zonjë, të shkruaj nga një

vend i vogël evropian. Jam 38-vjeçare, nënë e dy fëmijëve. Nga burri jam ndarë para dy vitesh dhe vazhdoj të punoj e t’i rrisë fëmijët, sepse janë me mua.

Por, e kam një hall: Të gjithë ikin prej meje!

Nuk më ofrohet askush, edhe pse unë nuk u bëj keq asgjë.

E, kjo po më dhemb në shpirt, sepse nuk po kam me kë ta shprehi asnjë brengë...

Çka të bëj që ta rifitojë rrethin tim ku ka edhe shqiptarë shumë?

“Nëna”

Përgjigje:

Ti jeton në një vend të vogël, që çdo gjë merret vesh shpejt, kuptohet shpejt.

Ti ke pasur lidhje me një person, banor i atjeshëm dhe të kanë dalë fjalë, e që kanë ndikuar në ndarjen bashkëshortore.

Etiketa imorale ka bërë që rrethi të shmanget prej teje, por edhe familja e burrit po bën propagandë të madhe që të largohen njerëzit prej teje. Sugjerimi im është: Të sillësh mirë me njerëzit aty dhe kudo që je dhe të jesh nënë dhe edukatore e mirë, e pastaj rrethi yt do të të rikthehet përsëri, duke u arsyetuar se jeni në rregull...

Më përqeshin, a m’i marrin mëkatet?

Përhëndetje zonjë e nderuar, jam një djalë i moshës 27-vjeçare. Nuk jam i shëmtuar, por jam pak i kërrusur, ashtu jam lindur nga Zoti. Kur eci ndjej rreth meje se ka njerëz që më përqeshin...

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

Ndihem shumë keq dhe, zakonisht, largohem me shpejtësi, e kjo ka bërë që të jem i turpshëm dhe skuqem kur flas.

A kam zgjidhje dhe a bëjnë mëkate ata që tallen me mua?

“I humburi”

Përgjigje:

Nuk ka gjë më të keqe se ta tallësh dikë, të cilin Zoti i madhërisëm e ka krijuar, e ka qit në dritë.

Ti nuk je fajtor që je lindur i tillë. Nuk ke mundur të ndikosh në barkun e nënës që ta zgjedhësh një formë trupore që ke dashur, prandaj nuk je fajtor për lindjen tënde, sido që është dhe sido që duket.

Nuk je fajtor që je lindur i tillë, por je fajtor pse nuk kujdesesh për ta përmirësuar trupin, sepse ka shumë mundësi ta përmirësosh çdo pjesë trupore që nuk është në rregull apo që është më pak në rregull se që duhet.

Ke mundësi t’i kushtosh trupit tënd kujdes. Të konsultohesh me ekspertë mjekësorë, qoftë edhe ekspertë të fitneseve, e që kanë njohuri në përmirësimin trupor dhe do të përfitosh prej tyre.

Të këshilloj ta përmirësosh gjendjen trupor. Këtë ia ke borxh vetes dhe do të arrish të dukesh shumë më mirë edhe të ndihesh i lumtur.



Kompleksi Eliza – Fushë Kosovë



www.cimaks.com



Tel: +355 69 258 8889  /unikhoteltirana



SHERWOOD

Resorts and Hotels



**SHERWOOD
EXCLUSIVE KEMER**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
EXCLUSIVE LARA**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
DREAMS RESORT**
BELEK / ANTALYA

**TUI BLUE
BELEK**
BELEK / ANTALYA

**SHERWOOD
SUITES RESORT**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
GREENWOOD RESORT**
KEMER / ANTALYA